

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 46106/15
Muhamet KUÇI dhe të tjerë
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 11 qershor 2024, si një Komitet i përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *Kryetar,*

Darian Pavli,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 46106/15) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 16 shtator 2015 nga tridhjetë e katër shtetas shqiptarë – detajet përkatëse të listuara në tabelën bashkëlidhur – (“kërkuesit”), të cilët u përfaqësuan nga z. R. Malaj, avokat, i cili e praktikon ligjin në Tiranë,

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën Qeverinë shqiptare (“Qeveria”), fillimisht e përfaqësuar nga agjenti i saj znj. A. Hicka, dhe në vijim nga z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja konkrete është vijimi i vendimit të Gjykatës për çështjen *Karagozji dhe të tjerë kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25408/06 dhe 9 të tjerë, 8 prill 2014) në lidhje me atë pjesë të vendimit që u referohet anëtarëve të familjes Okaj (kërkesa *Okaj kundër Shqipërisë*, nr. 15075/09). Ajo ka të bëjë me ankesat e kërkuesve sipas neneve 6 dhe 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për pretendimin për mosekzekutimin nga ana e autoriteteve të brendshme të një vendimi të formës së prerë sipas të cilit kërkuesve i akordohej kompensim në vend të rikthimit të pronës.

2. Më 3 tetor 1995, Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave Shkodër (“Komisioni i Shkodrës”) i riktheu titullin për pronën e trashëguar trashëgimtarëve të Y.O. për tri sipërfaqe toke me përmasat 4,910 m², 1,880 m² dhe 1,640 m², respektivisht, në total 8,430 m². Në vijim, Komisioni i Shkodrës vendosi se trashëgimtarët e Y.O. do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara në ligj në lidhje me një sipërfaqe tjetër toke me përmasa 2,833 m². Në fund, trashëgimtarëve iu njoh e drejta për refuzimin e parë të një tjetër sipërfaqeje toke me përmasa 14,537 m² (shih *Karagozji dhe të tjerë*, cituar më sipër, § 31).

3. Më 8 nëntor 2006, Gjykata e Rrethit Shkodër pranoi pretendimin e kërkuesve në kërkesën konkrete, anëtarë të familjes Kuçi, që të njiheshin si trashëgimtarë të Y.O., dhe pronarë të katër të pestës së pronës nga vendimi i mësipërm i Komisionit të Shkodrës të datës 3 tetor 1995, dhe i urdhëroi anëtarët e familjes Okaj, gjithashtu trashëgimtarë të Y.O., që t’i njihnin kërkuesit si bashkëtrashëgimtarë të asaj prone.

4. Vendimi i datës 8 nëntor 2006 u la në fuqi në apel më 28 qershor 2007, dhe më pas nga Gjykata e Lartë, më 28 tetor 2011.

5. Më 7 mars 2009, pjesëtarët e familjes Okaj e paraqitën kërkesën e tyre përpara Gjykatës duke pretenduar se autoritetet e brendshme nuk kishin ekzekutuar vendimin e datës 3 tetor 1995 të Komisionit të Shkodrës (shih paragrafin 2 më sipër) – një vendim administrativ i formës së prerë që kishte të bënte me të drejtën e pronësisë – i cili u rikthente kërkesve Okaj disa sipërfaqe të caktuara toke.

6. Më 8 prill 2014, Gjykata në vendimin e përmendur më sipër *Karagozji dhe të tjerë*, konstatoi, *inter alia*, se e drejta për gjykim të drejtë dhe për gëzimin paqësor të pasurive të tyre në rastin e kërkesve të familjes Okaj ishte shkelur për shkak se autoritetet e brendshme nuk kishin ekzekutuar për shumë vite vendimet e brendshme dhe nuk kishin paguar kompensimin që u ishte akorduar atyre (shih § 54 të vendimit *Karagozji dhe të tjerë*).

7. Gjykata u akordoi kërkesve në çështjen Okaj 820,500 euro (EUR) si kompensim për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si rezultat i shkeljeve të konstatuara, në lidhje me masën për t’iu rikthyer tri sipërfaqet e tokës me përmasa në total prej 8,430 m² ose për t’u kompensuar (shih *Karagozji dhe të tjerë*, cituar më sipër, §§ 31–34, dhe 58).

8. Më 11 mars 2015, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë miratoi vendimin nr. 217 për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës në çështjen *Karagozji dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, duke përfshirë edhe çështjen *Okaj kundër Shqipërisë*.

9. Më 14 maj 2015, përfaqësuesi i familjes Kuçi i kërkoi Avokatit të shtetit të kërkonte pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës për çështjen *Karagozji dhe të tjerë* për sa kishte të bënte me familjen Okaj, duke pretenduar se ai vendim kundërshtonte vendimin e formës së prerë të gjykatave të brendshme që njihje pronësinë e anëtarëve të familjes Kuçi ndaj katër të pestave të pronës së kontestuar, dhe se kjo gjë do ta ngarkonte shtetin shqiptar me detyrime të tjera.

10. Më 1 korrik 2015, Avokatura e Shtetit paraqiti pranë Gjykatës një kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të saj në çështjen *Karagozji dhe të tjerë kundër Shqipërisë*.

11. Më 3 dhjetor 2015, Gjykata e rrëzoi kërkesën e Qeverisë për rishikim.

12. Vendimi *Karagozji dhe të tjerë*, për sa ka të bëjë me çështjen Okaj, është ekzekutuar dhe në vitin 2015 pjesëtarëve të familjes Okaj iu pagua kompensimi i akorduar nga Gjykata (shih komunikimin e Qeverisë për Komitetin e Ministrave në DH-DD(2018)592, dhe rezolutën CM/ResDH(2018)349, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 shtator 2018, në takimin e 1324-t të zëvendësministrave).

LIGJI I BRENDSHËM RESPEKTIV

13. Neni 349 i Kodit Civil parashikon se një trashëgimtar mund të depozitojë një padi civile ndaj cilitdo personi i cili zotëron cilëndo pjesë të pronës së tij të trashëguar, duke kërkuar njohjen e së drejtës së tij si trashëgimtar dhe dorëzimin e kësaj pasurie trashëgimore, dhe të pasurisë së fituar me anë të saj, në mbështetje të rregullave përkatës në lidhje me zotërimin në mirëbesim ose në keqbesim.

14. Në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 29026/06 dhe 11 të tjerë, §§ 29–109, 17 mars 2020) paraqitet një përmbledhje e ligjit të brendshëm respektiv në lidhje me ligjin nr. 133/2015, të datës 5 dhjetor 2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (“Ligji për pronën 2015”).

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Argumentet e palëve

15. Në konstatimet e tyre shtesë të paraqitura në vitin 2024, Qeveria parashtroi, *inter alia*, se kërkesit nuk kishin shteruar në mënyrën e duhur mjetet e brendshme, pasi nuk kishin kërkuar nga gjykatat e brendshme kompensimin për pjesën e tyre të pronës si trashëgimtarë të Y.O. sipas vendimit të Komisionit të Shkodrës të datës 3 tetor 1995. Gjithashtu, kërkesit nuk kishin përdorur mjetin në mbështetje të nenit 349 të Kodit Civil, dhe as mjetet e parashikuara në ligjin për pronën 2015.

16. Kërkesit argumentuan se as gjykatat e brendshme, dhe as ndonjë autoritet tjetër i brendshëm, nuk kishin kompetencën për të ndryshuar apo për të vepruar në kundërshtim me vendimin e Gjykatës.

Gjithashtu, ata parashtruan se nuk ekzistonte asnjë mjet i brendshëm efektiv për njohjen e pjesë së tyre të pronës në fjalë.

B. Vlerësimi i Gjykatës

17. Parimet e përgjithshme për shterimin e mjeteve vendase janë përmbledhur në vendimin *Vučković dhe të tjerë kundër Serbisë* (kundërshti paraprake) ([DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69–77, 25 mars 2014, dhe *Gberghina kundër Romanisë* (vendim) [DHM]. nr. 42219/07, §§ 83–89, 9 korrik 2015).

18. Në çështjen e përmendur më sipër *Beshiri dhe të tjerë*, Gjykata vlerëson se ligji për pronën 2015 është përgatitur për të adresuar çështjen e zbatimit të së drejtës së ish-pronarëve për kompensim në mënyrë efektive dhe kuptimplotë, duke pasur në konsideratë kërkesat e Konventës, dhe se ligji për pronën 2015 zbatohet për të gjithë individët që kanë depozituar një kërkesë pranë Gjykatës përpara hyrjes në fuqi të ligjit për pronën 2015 (shih, veçanërisht, §§ 215 dhe 217).

19. Për t'u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Rrethit Shkodër i datës 8 nëntor 2006, siç edhe u konfirmua përfundimisht nga Gjykata e Lartë më 28 tetor 2011, i njihje pjesëtarët e familjes Kuçi si bashkëpronarë të pronës objekt i vendimit të Komisionit të Shkodrës të datës 3 tetor 1995. Në këtë mënyrë, sipas atij vendimi, kërkuetit mund të kërkonin përpara gjykatave të brendshme të merrnin pjesën e tyre të pasurisë në fjalë nga palët e treta, duke përfshirë pjesën e tyre për çfarëdo kompensimi të përfituar për shkak të moskzekutimit nga ana e Shtetit e vendimit të Komisionit të Shkodrës të datës 3 tetor 1995. Nëse dëshirojnë këtë gjë, ata mund të kërkonin edhe dëmshpërblimin që mund të vinte si pasojë e kësaj. Megjithatë, nuk ka prova se kërkuetit i kanë përdorur këto mjete.

20. Gjithashtu, siç përcaktohet nga Qeveria në parashtrimet e saj, ata mund të ndjekin çdo mjet në mbështetje të ligjit për pronën 2015 për moskompensimin e tyre nga ana e autoriteteve për pjesën e tyre të trashëguar të pasurisë subjekt i vendimit të Komisionit të Shkodrës të datës 3 tetor 1995.

21. Për rrjedhojë, kjo ankesë duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrim të mjeteve të brendshme.

22. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ankesa e kërkuetesve sipas nenit 13 të Konventës është e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 4 korrik 2024.

Olga Chernishova **Ioannis Ktistakis**

Zëvendëssekretare Kryetar

SHTOJCË

Lista e kërkuetesve

Kërkesa nr. 46106/15

Nr.	Emri i kërkuetit	Viti i lindjes/regjistrimit	Kombësia	Vendbanimi
1	Muhamet KUÇI	1950	Shqiptar	Shkodër
2	Valdete BALLAJ (KOTRRI)	1950	Shqiptare	Shkodër
3	Liljana BUSHATI (KOTRRI)	1960	Shqiptare	Shkodër
4	Drita DERVISHI (KOTRRI)	1949	Shqiptare	Tiranë
5	Bashkim DUMA	1948	Shqiptar	Shkodër
6	Besim DUMA	1950	Shqiptar	Shkodër
7	Burhan DUMA	1941	Shqiptar	Shkodër

Nr.	Emri i kërkuesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Kombësia	Vendbanimi
8	Mehmet DUMA	1936	Shqiptar	Sant Antonio
9	Mzyafer DUMA	1953	Shqiptar	Shkodër
10	Fitnete HYSAJ (SUMA)	1963	Shqiptare	Jacksonville
11	Hyrije ISUFI (KRAJA)	1936	shqiptare	Shkodër
12	Abaz KOTRRI	1935	shqiptar	Shkodër
13	Enver KOTRRI	1952	shqiptar	Shkodër
14	Petrit KOTRRI	1961	shqiptar	Shkodër
15	Skender KOTRRI	1957	shqiptar	Shkodër
16	Edmond KRAJA	1968	shqiptar	Shkodër
17	Lindita KRAJA	1972	shqiptare	Shkodër
18	Mirjeta KRAJA	1974	shqiptare	Tiranë
19	Muhamet KRAJA	1936	shqiptar	Shkodër
20	Sabahete KRAJA	1945	shqiptare	Shkodër
21	Sejfullah KRAJA	1944	shqiptar	Shkodër
22	Minire KRAJA (KUÇI)	1943	shqiptare	Shkodër
23	Bujar KUÇI	1956	shqiptar	Shkodër
24	Dilaver KUÇI	1958	shqiptar	Shkodër
25	Faik KUÇI	1953	shqiptar	Shkodër
26	Mit-hat KUÇI	1945	shqiptar	Shkodër
27	Bukurije PIRANEJ (KUÇI)	1948	shqiptare	Shkodër
28	Dashmir PLORI	1968	shqiptar	Shkodër
29	Mentor PLORI	1970	shqiptar	Shkodër
30	Sabahete PLORI (DUMA)	1944	shqiptare	Shkodër
31	Sabahete SEITAJ (SUMA)	1968	shqiptare	Shkodër
32	Suzana SELHANEJ (KOTTRI)	1955	shqiptare	Shkodër
33	Eqrem SUMA	1966	shqiptar	Shkodër
34	Xhevrije SUMA	1935	shqiptare	Shkodër